

# Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis Paraparak

PER AKTIVITETIN:

PRODHIM I LLAÇRAVE TE THATA (KOLLE, FINO, LLAÇ I THATE, GRAFIATO ETJ)

*Shtojca II pika 5 b “Instalimet per prodhimin e çimentos”*

ME VENDODHJE:

Rruga Martin Camaj, unaza Shkozet-Plepa DURRES

Kerkues:

Subjekti “BAMAS-BROLI”

Hartoi raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis:

GEC studio

Punoi:

Ing. Dhurata Lumani



Tetor 2015



## TABELA PERMBLEDHESE

<b>1</b>	<b>TE PERGJITHSHME</b> .....	<b>4</b>
1.1	HYRJE.....	4
1.2	MJEDISI DHE PARIMET PER MBROJTJEN E TIJ.....	5
1.3	TE DHENA TE PERGJITHSHME RRETH AKTIVITETIT .....	6
1.4	PROCESI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS .....	7
1.5	KËRKESAT E STUDIMIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS.....	8
<b>2</b>	<b>PERSHKRIM I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL</b> .....	<b>10</b>
2.1.	QELLIMI I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS .....	9
2.2.	LEGJISLACIONI KOMBETAR .....	11
2.3.	PERMBLEDHJE E KUADRIT LIGJOR.....	13
2.4.	KUADRI INSTITUCIONAL .....	15
2.5.	LEGJISLACIONI EUROPIAN PER MBROJTJEN E MJEDISIT .....	19
2.6.	METODOLOGJIA E VLERESIMIT .....	23
<b>3</b>	<b>PERSHKRIMI I AKTIVITETIT</b> .....	<b>26</b>
3.1.	QELLIMI I AKTIVITETIT .....	26
3.2.	TE DHENA TEKNIKE TE AKTIVITETIT .....	26
3.3.	VENDODHJA E AKTIVITETIT .....	27
3.4.	LIDHJA E OBJEKTIT ME INFRASTRUKTUREN INXHINIERIKE .....	28
3.5.	PËRSHKRIMI I PROCESIT TEKNOLOGJIK TE FABRIKES.....	29
3.6.	INFORMACION PËR SHKARKIMET NË MJEDIS.....	33
3.7.	CILËSIA E AJRIT DHE UJËRAVE SIPËRFAQËSORE NË ZONËN E ZBATIMIT TE PROJEKTIT .....	33
3.8.	PIKAT KU DO TË KRYHEN SHKARKIMET NË AJËR DHE KU DO TË SHKARKOHEN UJËRAT E NDOTURA .....	33
3.9.	RREZIQET/AKSIDENTET E MUNDSHME NË MJEDIS TË VEPRIMTARISË.....	33

**BAMAS-BROLI**  
**PRODHIM I LLAÇRAVETË THATA (KOLLË, FINO, LLAÇ I THATË, ETJ)**

<b>4</b>	<b>PERSHKRIM I MJEDISIT TE RAJONIT .....</b>	<b>34</b>
4.1.	PERSHKRIMI I KARAKTERISTIKAVE FIZIKE PER ZONEN E DURRSIT.....	34
4.2.	EKOSISTEMET HABITATET DHE PEISAZHI.....	36
4.3.	POPULLSIA,KLIMA,INFRASTRUKTURA.....	37
4.4.	TOKA ,KATEGORIA E TOKES .....	39
4.5.	TRASHEGIMIA ARKITEKTONIKE DHE HISTORIKE.....	40
4.6.	TE DHENAT HIDROLOGJIKE.....	41
4.7.	TE DHENAT SIZMIKE.....	42
4.8.	UJI ,AKUA FERRET,RRUGET UJORE,BRIGJET.....	42
<b>5</b>	<b>IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS TE PROJEKTIT .....</b>	<b>43</b>
5.1.	TE PERGJITHSHME .....	43
5.2.	NDIKIMET E PRITSHME NE MJEDIS .....	43
5.3.	MATRICAT PERMBLEDHESE KRYESORE TE NDIKIMEVE NE MJEDIS .....	45
5.3.1.	Permbledhje e ndikimeve negative ne mjedis.....	46
5.3.2.	Permbledhje e ndikimeve pozitive ne mjedis.....	46
5.4.	ANALIZA SWOT .....	50
<b>6</b>	<b>MASAT KRYESORE LEHTESUESE .....</b>	<b>52</b>
6.1.	MASAT LEHTESUESE QE DUHET TE NDERMERREN GJATE AKTIVITETIT .....	52
<b>7</b>	<b>PROGRAMI MONITORIMIT .....</b>	<b>53</b>
7.1.	SKEMA E MONITORIMIT TE TREGUESVE MJEDISOR. ....	53
<b>8</b>	<b>REKOMANDIME .....</b>	<b>54</b>

## **1 TE PERGJITHSHME**

### **1.1 Hyrje**

Vendi yne gjate viteve te fundit ka miratuar nje sere ligjesh dhe vendimesh te Keshillit te ministrave ne fushen e mbrojtjes se mjedisit, duke permiresuar ndjeshem legjislacionin mjedisor dhe social ekonomik te vendit. Gjithashtu gjate kesaj periudhe Shqiperia ka nenshkruar edhe nje sere konventash dhe protokollesh ne klimen e permiresimit te cilesise mjedisore ne vend dhe rajon. Disa prej ketyre konventave te nenshkruara jane:

Nenshkrimi i nje sere konventash dhe miratimi i kuadrit ligjor per mjedisin ne funksion te tyre, detyron institucionet shteterore dhe subjektet fizike e juridike ti nenshtrohen disa procedurave profesionale para miratimit te projektit te tyre.

Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) eshte nje prej instrumentave parandalues dhe minimizues te ndikimit mjedisor dhe per projektin specifik, hartohet duke u bazuar ne zhvillimin strategjik te zones se Durrsit. Perfshin vleresimin, identifikimin, si dhe percaktimin e masave zbutese te ndikimit te aktivitetit per prodhimin e llacrave te thata. Ky raport i VNM-se po pergatitet me kerkese te perfaqesuesit ligjor te Subjektit "BAMAS-BROLI" Sh.p.k, Z. Julian Broli. Aktiviteti i shoqerise zhvillohet ne nje kapanon metalik i ndertuar prane rruges B.Curri ne lagjen 13 ne Durres. Ne kete faze, Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis realizohet per impiantin dhe aktivitetin e prodhimit te llacrave te thata per ndertim. Subjekti ka instaluar nje impiant modern te kompjuterizuar, ku procesi i prodhimit kryhet kryesisht nga makinerite, nen supervizionin e disa punetoreve dhe drejtuesit te komandave kompjuterike.

## 1.2 Mjedisi dhe parimet per mbrojtjen e tij

Ne kushtetuten e Republikes se Shqiperise kerkohet: "Mirembajtje e nje mjedisi teper te shendetshem dhe ekologjik per brezat e tanishem dhe te ardhshem". Kjo, por edhe opinioni i gjithe shoqerise i shprehur nepermejt ligjeve te tjere, detyron marrjen e masave imediate per rehabilitimin e mjedisit te degraduar gjate dekadave te fundit.

Ky raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, hartohet mbi bazen e mbrojtjes se mjedisit dhe ne funksion te institucioneve vendim-marrese per licensimin ose jo te aktivitetit ne vleresim. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme veprimtarite te cilat zhviloohen duke pasur parasysh parimet baze te mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

Parimet e mbrojtjes së mjedisit:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi "Ndotësi paguan"
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nenkupton mbrojtjen e integruar te përbërësve të mjedisit nga ndotja, si veçmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre dhe qysh ne fazen e planifikimit te zhvillimit te nje territori te caktuar.

Mbrojtja e Perbersve te mjedisit klasifikohet ne:

- Mbrojtja e ajrit
- Mbrojtja e ujërave
- Mbrojtja e tokës
- Mbrojtja e natyrës
- Ndryshimet klimatike

### 1.3 Te dhena te pergjithshme rreth aktivitetit

Subjekti “BAMAS-BROLI” Sh.p.k i regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, mbajtes i numrit unik te identifikimit te subjektit (NIPT)KO1328505B, me seli në, Durres rruga B.CURRI L.13 Unaza Plazh dhe vend te fabrikes prodhuese Rruga Martin Camaj,unaza Shkozet-Plepa DURRES me administrator Z.Julian Broli dhe Z.Zija Broli ushtron aktivitetin e prodhimit te llacrave te thata si kolle, fino, llac i thate, etj.

Subjekti, per zhvillimin e aktivitetit te tij eshte paisur me te gjitha miratimet perkatese te lejeve te nevojshme per objektin dhe eshte duke aplikuar per paisjen me lejen mjedisore te funksionimit te aktivitetit. Ky aktivitet ndodhet ne zone industriale dhe ne perputhje me planet e zhvillimit dhe studimet urbanistike te zones.

Objekti i kaponit ne dispozicion te ketij aktiviteti ka keto te dhena urbanistike:

Siperfaqe e objektit(njolla e ndertimit)	= 500m <sup>2</sup>
Koeficienti i shfrytezimit te territorit	=37
% Koeficienti i siperfaqes se gjelbert	=20 %

Kapaciteti prodhues i produktit perfundimtar do te jete rreth 4 ton/dite. Kapaciteti magazinues rreth 1000 ton, ku destinacioni eshte kryesisht per eksport.

Uji sigurohet me pus dhe ne ambjentin e fabrikes eshte ndertuar edhe sistemi zjarrfikes ne funksion te objektit dhe zyrave. Ky investim eshte kryer per te rritur sigurine ne objekt dhe per te garantuar investimin e impiantit modern dhe plotesisht automatik.



#### **1.4 Procesi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis**

Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) siguron një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e sheshit të zhvillimit të aktivitetit duke përfshirë kushtet fizike atmosferike dhe të burimeve ujore dhe biologjike, burimet kulturore dhe gjendjen social-ekonomike të zonës. Në procesin studimor të VNM përdoren informacioni dhe të dhënat ekzistuese dhe të përfituara rishtas mbi kushtet e sheshit, së bashku me standardet dhe normat e zbatueshme për të vlerësuar impaktet potenciale mjedisore dhe sociale të fasiliteteve të propozuara.

#### **1.5 Kërkesat e studimit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis**

Impaktet potenciale mjedisore të shqyrtuara dhe të analizuara në procesin e VNM dhe social përfshijnë impaktet ndaj cilësisë së mjedisit bimor të flores dhe të faunes, situatën social-ekonomike dhe kulturore të zhvillimit të zonës. Burimet e vlerësuara social-kulturore përfshijnë punësimin, përdorimin e tokës, peshkimin, lundrimin lokal, transportin rrugor dhe hekurudhor dhe shërbimet e komunitetit vendas.

VNM përvijon gjithashtu edhe masat zbutëse për t'u zbatuar për të ndihmuar parandalimin ose minimizimin e ndikimeve negative, siç mund të jetë e praktikueshme, të impakteve mjedisore dhe sociale të projektit të propozuar. Këto raportohen në detaje në planin e menaxhimit të mjedisit (PMM) dhe Planin e Rehabilitimit të Mjedisit (PRM), të cilat janë pjesë e raportit. VNM-ja përbëhet nga tërësia e procedurave të Ndërtimit dhe funksionimit të veprës, monitorimit, zbatjes dhe masave institucionale që do të zbatohen gjatë punimeve operacionale në terren.

Plani raporton edhe veprimet që nevojiten për t'i zbatuar këto masa. Për më tepër, VNM-ja trajton menaxhimin specifik të mjedisit dhe planet dhe strategjitë monitoruese dhe identifikon çdo kërkesë dhe afat të domosdoshëm të duhur.

#### **Korniza kryesore e kuadrit ligjor për përgatitjen e Raportit të VNM-se:**

- **Ligji Nr 10431 datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”**
- **Ligji Nr 10440 datë 07.07. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit Në Mjedis”**
- **Ligj Nr. 10448, date 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”**
- **Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”.**
- **Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”**

- **Vendim i KM Nr. 16, date 14.01.2012 “Per te drejten e publikut per te pasur informacion mjedisor”**
- **Vendim i KM Nr. 13, date 04.01.2013 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”**
- **Udhezim Nr. 3, date 02.12.2013 “Per Dokumentacionin e domosdoshem per te kerkuar leje mjedisore te tipit A, B dhe C per aktivitete te reja dhe ekzistuese”.**

Metoda e pergatitjes se VNM

Ligji mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis (VNM) percakton tipin dhe shkallen e projekteve apo veprimtarive qe kerkojne VNM para implementimit. Kategorite e VNM-ve jane:

VNM e permbledhur. Ky vlen per projekte qe mund te kene impakte potenciale me te vegjel ne permasa qe serish kerkojne nje vleresim profesional te impakteve te tyre. Keto perfshijne projekte qe jane listuar ne Shojcen 2 te Ligjit per VNM dhe ndryshime apo rehabilitime te projekteve te listuar ne Shtojcen 1.

VNM i Thelluar. Ky vlen per projekte me impakte potencialisht te konsiderueshme, siç figurojne ne listen e Shojcës 1 te Ligjit, ato projekte te listuara ne Shtojcen 2 per te cilet MMPAU mendon se do te kene nje impakt te konsiderueshem mbi mjedisin (bazuar ne informacionin e siguruar nga propozuesi ne kohen e aplikimit, ne menyren e detajuar ne Shtojcen 3 te Ligjit) dhe veprimtarite qe jane per tu implementuar ne zonat e mbrojtura te Republikes se Shqiperise apo zona bregdetare te Shqiperise.

Per hartimin e raportit te VNM, porositesi vuri ne dispozicion te hartuesve te raportit materialin teknik te disponueshem, juridik e stafin e subjektit dhe perfaqesuesit ne ambientin e fabrikes. Me bashkepunimin e subjektit kerkues “BAMAS-BROLI” Sh.p.k u kryen vizita ne terren nga grupi i punes.

MMPAU eshte autoriteti kompetent ligjor per te kerkuar, analizuar dhe aprovuar dokumentacionin VNM, ku projekti ne vleresim do ti nenshtrohet procedurave te raportit te permbledhur te VNM-se.



## **2 PERSHKRIM I KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL**

### **2.1. Qellimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis**

VNM eshte nje proces sistematik per te percaktuar dhe vleresuar efektet apo ndikimet ne mjedis te nje veprimi apo projekti te caktuar. Ne nje situatë normale, ky proces aplikohet perpara se te merret vendimi dhe te fillojne angazhimet per realizimin e projektit. Po sidoqofte, dhe ne çdo kohe, efektet sociale, kulturore dhe shendetesore jane konsideruar si pjese integrale e VNM. Kujdes i veçante i kushtohet praktikave te VNM per te parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative te veprimeve te ndermarra.

Qellimi i VNM eshte te:

- Te jape informacion per vendimmarresit per pasojat mjedisore te studimet e propozuara; dhe
- Te promovojë zhvillimin miqesor dhe te qendrueshem me mjedisin duke identifikuar masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis

Reduktimi i ndikimeve ne mjedis arrihet nese nje zhvillim behet i qendrueshem me mjedisin. Keto ndikime jane mjaft komplekse, me te medha ne shkalle dhe per me teper shtrijne pasojat e tyre me shume se 20 vjet me pare ku u fut koncepti i VNM ne vendin tone. Si rezultat, VNM eshte kthyer ne nje vegël kyç per vendimarrjen per nje zhvillim te propozuar.

Ne aspektin nderkombetar, roli i VNM eshte njohur ne Principin e 17 te Deklarates per mjedisin dhe Zhvillimin.

VNM, si nje instrument kombetar duhet te aplikohet per aktivitetet e propozuara te cilat pritet qe te kene ndikim negativ ne mjedis dhe jane subjekt i nje vendimarrje te nje autoriteti kombetar.

Qellimi dhe objektivat e VNM mund të ndahen në dy kategori.

Qellimi i parë, drejtperdrejtë, është të informojë procesin e vendimarrjes duke identifikuar të konsiderueshem potencialet në mjedis dhe rreziqet e perfitimet e projektit dhe zhvillimit të propozuar.

Qellimi perfundimtar, afatgjatë i VNM është të promovojë zhvillimin e qëndrueshem duke siguruar që propozimet e projektit nuk minojnë burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe të njerezeve që lidhen apo varen nga ky projekt ose aktivitet.

Objektivat afatshkurter dhe të drejtperdrejte të VNM:

1. Permiresim nga pikepamja mjedisore i propozimit dhe projektit;
2. Siguron që burimet natyrore janë perdorur në menyren e duhur dhe me efçence;
3. Identifikon masat e duhura për zvogelimin e ndikimeve të mundshme potenciale të projektit apo propozimit; dhe
4. Lehtëson informimin e vendimmarresit, duke përfshirë vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore për zbatimin e projektit apo propozimit.

Objektivat afatgjatë të VNM janë:

- Siguron dhe mbron shëndetin e njeriut;
- Parashikon dhe përjashton ndryshimet e pakthyeshe dhe demtimet serioze të mjedisit;
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peisazhet e natyres dhe komponentet përberes të ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale të projektit

## 2.2. Legjislacioni Kombetar

Per me siper, ky Raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, eshte mbështetur ne legjislacionin mjedisor si me poshte dhe ka per qellim qe te identifikojë, parashikojë dhe parandalojë ndikimin e këtij aktiviteti ne mjedis.

Kuadri për VNM-ne sigurohet ne menyre te drejtperdrejte nga dy ligje për mjedisin në Shqipëri. Në mënyrë të veçantë, ligjet e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor (VNM) janë zhvilluar dhe kanë hyrë në fuqi gjatë dekadës së fundit.

Sipas Ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”, pika 3.9 dhe VKM Nr. 538, date 26.05.2009 “Per licensat dhe lejet qe trajtohen nepermjet QKL, Fusha III, Kategoria III.1, pika 3, ky aktivitet, mund te pajiset me Leje Mjedisore te tipit C, nenkategoria III.1.A, por sipas konsultimeve paraprake me Agjencine Kombetare te Mjedisit, eshte rekomanduar aplikimi dhe paisja me leje mjedisore tipi B.

Ligji mbi Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis (VNM) percakton tipin dhe shkallen e projekteve apo veprimtarive qe kerkojne VNM para implementimit. Kategorite e VNM-ve jane:

- VNM e permbledhur.
- VNM i Thelluar.

Aktiviteti ne vleresim, ne baze te klasifikimit te tij si aktivitet me ndikim te vogel ne mjedis, klasifikohet si raport i permbledhur i VNM.

Legjislacioni mjedisor eshte hartuar per te mbrojtur dhe parandaluar komponente te vecante dhe te rendesishem te mjedisit. Keshtu, nder ligjet me specifike qe kane lidhje te drejtperdrejte me projektin ne vleresim, mund te permendim:

Ne ligjin Nr. 10 431, date 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” theksohet ne kapitullin V (VNM) neni 25 se:

Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi dhe para kërimit të lejeve përkatëse të zhvillimit.

Ne Ligjin Nr.10 440, date 07.07.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” ne kreun II, neni 7 per “Procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis” thuhet:

Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

- a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Dokumenti bazë ku mbështetet procesi i VNM-së dhe licencimi, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

- a) raporti paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës II;
- b) raporti i thelluar i VNM-së për projektet e shtojcës I.

Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin indentifikimin, saktësimin dhe vlerësimin e drejtperdrejte dhe të terthorte të projektit në mjedisin ku do të zbatohet, si dhe percaktimi i masave për të parandaluar dhe zbutur demtimet në mjedis që në fazën fillestare të tij.

Aktiviteti i shoqërisë **"BAMAS-BROLI"** Sh.p.k, në bazë të klasifikimit të tij që bën pjesë në aneksin 2 të ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, klasifikohet si VNM e përmbledhur. Legjislacioni mjedisor është hartuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponente të veçante dhe të rëndësishme të mjedisit.

Ky raport hartohet mbi bazën e mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim-marrëse për licensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme.

Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë veprimtaritë të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet bazë të mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

Parimet e mbrojtjes së mjedisit

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
- Parimi "Ndotësi paguan"
- Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nenkupton mbrotjen e integruar te përbërësve të mjedisit nga ndotja, si veçmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre dhe qysh ne fazen e planifikimit te zhvillimit te nje territori te caktuar.

Mbrojtja e Perbersve te mjedisit klasifikohet ne:

- Mbrojtja e ajrit
- Mbrojtja e ujërave
- Mbrojtja e tokës
- Mbrojtja e natyrës
- Ndryshimet klimatike

### 2.3. Permbledhje e kuadrit ligjor

Legjislacioni mjedisor eshte ndertuar per te mbrojtur dhe parandaluar komponente te veçante dhe te rendesishem te mjedisit. Keshtu, nder me specifiket mund te permendim:

- **Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e Mjedisit”**
- **Ligji Nr.10 440, datë 7.7. 2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.**
- **Ligj Nr. 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”**
- **Ligji Nr. 10 463, datë 22.9. 2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”  
Vendim Nr. 177, datë 6.3.2012 “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”**
- **Ligj Nr. 10119 date 23.04.2009 “Per planifikimin e territorit”**
- **Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”.**
- **Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”**
- **Ligji Nr.10 081, datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.**

- **Vendim i KM Nr.1189, Datë 18.11.2009 “Për Rregullat Dhe Procedurat Për Hartimin Dhe Zbatimin e Programit Kombëtar Të Monitorimit Të Mjedisit”**
  - **Vendimi i KM Nr. 805, dt 04.12.2003 “Per miratimin e listes se veprimtarive, qe ndikojne ne mjedis, per te cilat kerkohet Leje Mjedisore”.**
  - **Vendimi i KM Nr.247, datë 30.04.2014 “Për tërheqjen e mendimit te publikut në vendimmarrje për mjedisin”.**
  - **Vendim i KM Nr. 123, datë 17.2.2011 “Per menaxhimin e zhurmave”**
  - **Vendim i KM Nr. 313, dt. 09.05.2012 “Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis”**
  - **Vendim i KM Nr. 99, datë 18.2.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”**
  - **Vendim i KM Nr. 177, datë 31.3.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjedisëve ujore pritëse”**
  - **Vendim i KM Nr. 538 dt.26.05.2009 “Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregulla te tjera”**
  - **Vendim i KM Nr. 16, date 14.01.2012 “Per te drejten e publikut per te pasur informacion mjedisor”**
  - **Vendim i KM Nr. 13, date 04.01.2013 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”**
  - **Vendim Nr. 676, datë 20.12.2002 “Për shpalljen e zonave te mbrojtura monument natyror”**
- 
- **Udhëzim, Nr.5, datë 28.12.2007, “Për tarifatat e shërbimit për lejet mjedisore”.**
  - **Udhëzim Nr. 8, dt.27.11.2007 “Per nivelet kufi te zhurmave ne republiken e shqiperise.**
  - **Udhëzim Nr. 3, date 02.12.2013 “Per Dokumentacionin e domosdoshem per te kerkuar leje mjedisore te tipit A, B dhe C per aktivite te reja dhe ekzistuese”.**

Ne parlamentin Shqiptar janë miratuar edhe disa ligje në kuadër të përfshirjes së vendit tonë në Protokolle dhe marrëveshje të ndryshme. Nder të përmendim:

- **Ligji Nr. 9672 datë 26.10.2000: “Për ratifikimin e konventës së Aarhusit” Për të drejtën e publikut për të pasur informacion dhe përfshirjen në vendimarrje, si dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit.**
- **Ligji Nr. 9334 datë 16.12.2004: “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kiotos” në konventën për ndryshimet klimatike (UNFCCC).**
- **Ligji Nr. 9424 datë 06.10.2005: “Për ratifikimin e protokollit të vlerësimit strategjik mjedisor”.**
- **Ligji Nr. 9486 datë 06.03.2006: “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Amendamentin e Pekinit për protokollin e Montrealit” Për substancat që hollojnë shtresën e Ozonit.**
- **Ligji Nr. 9548 datë 01.06.2006: “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin për regjistrat e shkarkimit dhe transferimit të ndotesve”**

#### **2.4. Kuadri institucional**

##### **Institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit**

Institucioni kryesor dhe më i rëndësishëm në fushën e mjedisit është Ministria e Mjedisit. Në varësi të kësaj ministrie janë edhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Drejtorite Rajonale të Mjedisit, si dhe Drejtorite Rajonale të Menaxhimit të Pyjeve. Ministria e Mjedisit është e përbërë nga 12 Drejtoritë Rajonale të Mjedisit të cilat ushtrojnë funksion lokal në rang prefekturë dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit e cila ka funksion kombëtar. Institucione të tjera përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit janë edhe Pushteti vendor, si dhe Ministri të tjera si ajo e Transporteve, e Bujqësisë, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, etj, sipas fushës së veprimtarisë.

### **Ministria e Mjedisit (MM)**

Ministria e Mjedisit, është autoriteti kryesor përgjegjës për menaxhimin dhe mbrojtjen e mjedisit dhe hartimin e politikave mjedisore në nivel kombëtar. Ministria e Mjedisit u krijua si organi shtetëror i specializuar për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri. Ajo harton dhe zbaton politiken e qeverisë për mbrojtjen e mjedisit, harton projekt-akte ligjore e nen-ligjore në funksion të mbrojtjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm të mjedisit, bashkërendon aktivitetet e institucioneve të linjes për ceshtje të mjedisit, organizon dhe koordinon punën për monitorimin e mjedisit, përgatit projekt-marrëveshjet ndërkombëtare apo bilaterale për mbrojtjen e mjedisit, përgatit Raportin vjetor “Për Gjendjen e Mjedisit”, shqyrton dhe jep aktet e miratimit të lejeve mjedisore për aktivitetet e ndryshme ekonomike, etj.

Në bazë të ligjit për mbrojtjen e mjedisit, neni 67, përgjegjësit kryesorë të MMPAU janë:

Si institucion qendror i specializuar për mbrojtjen e mjedisit dhe si mbështetëse teknike e Ministrisë, Ministria kryen edhe këto detyra kryesore:

- a. bashkëpunon me institucionet qendrore, me organet e qeverisjes vendore, me publikun dhe organizatat jofitimprurëse mjedisore e profesionale, për të rritur shkallën e zbatimit të legjislacionit mjedisor;
- b. përgatit projektet e marrëveshjeve, të protokolleve e programeve të bashkëpunimit dy e shumëpalësh, me shtete, organe dhe organizata ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit dhe ndjek zbatimin e tyre;
- c. studion nevojat e vendit për specialistë për mbrojtjen e mjedisit dhe bashkërendon me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për kualifikimin e specializimin e tyre;
- d. mbështet projekte për punë kërkimore-shkencore, për përmirësimin e gjendjes së mjedisit, për futjen e teknologjive ekologjike të pastra, për nxitjen e veprimtarive të organizatave jofitimprurëse mjedisore;
- e. ndihmon organet e qeverisjes vendore për mbrojtjen e mjedisit dhe për hartimin e zbatimit të planeve vendore për mjedisin.



## **Agjencia Kombetare e Mjedisit (AKM)**

Ne ligjin e ri per mbrojtjen e mjedisit, Nr. 10431, date 09.06.2011, ne Nenin 59 "Organizimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" percaktohet:

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është institucion qendror publik në varësi të ministrit, që ushtron juridiksionin e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes zyrës qendrore dhe degëve rajonale në qarqe, të cilave këtu e më poshtë do t'u referohemi si agjencitë rajonale të mjedisit.
2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit financohet nga Buxheti i Shtetit dhe burimet e veta.
3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka pavarësi në vendimmarrjen dhe kryerjen e funksioneve të saj, të parashikuara në këtë ligj.
4. Këshilli i Ministrave, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, miraton rregulla të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe të agjencive rajonale të mjedisit, ndarjen dhe organizimin e punës, statusin e punonjësve dhe marrëdhëniet e saj me institucione të tjera.
5. Kryeministri, me propozimin e ministrit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, miraton strukturën dhe organikën e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe të agjencive rajonale të mjedisit.

Ndersa ne Nenin 60, te ketij ligji percaktohen funksionet e ketij institucioni.

Funksionet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit:

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti kompetent për përcaktimin e kushteve për lejet përkatëse të mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me legjislacionin për lejet e mjedisit dhe me dispozitat e ligjeve të tjera përkatëse dhe ka këto funksione:
  - a. hartimin e Programit Kombëtar për Monitorimin e Mjedisit dhe monitorimin e gjendjes së mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
  - b. përgatitjen dhe publikimin e raporteve vjetore për gjendjen e mjedisit;
  - c. kryerjen e shërbimeve të matjes së shkarkimeve në mjedis me kërkesë të ministrisë;
  - b) këshillimin e organeve vendore për zbatimin e politikave mjedisore;
    - a. krijimin dhe menaxhimin e sistemit të informacionit mjedisor;
    - b. krijimin dhe menaxhimin e Regjistrit të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve;

- c. sigurimin e informacionit mjedisor për publikun, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
  - d. sigurimin e informacionit për publikun për procesin e vendimmarrjes për çështjet mjedisore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
  - e. sigurimin e zbatimit të parimit të përgjegjësisë mjedisore për çdo operator, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
  - f. menaxhimin e sistemit të të dhënave për pyjet.
2. Kjo agjenci kryen edhe funksione të tjera që i ngarkohen me legjislacion të posaçëm.

### **Autoritete te Tjera ne Nivel Qendror**

Komisioni i perhershëm për shëndetin dhe mjedisin punon për Parlamentin dhe rishikon draftet e ligjeve të përgatitura nga MMPAU, aprovon marrëveshje mjedisore ndërkombëtare dhe të tjera në lidhje me çështjet mjedisore. Mandati i tij përcaktohet nga Parlamenti dhe anëtarët e tij janë përfaqësues nga të gjitha grupet parlamentare. Komisioni rishikon dhe përgatit aktet ligjore që duhen miratuar nga Parlamenti. Ka të drejtën të mbikqyrë aktivitetet e MMPAU sipas rastit kur ka interesim të vecantë të publikut.

### **Niveli Rajonal dhe Vendor**

Në nivel prefektural vepron 12 Drejtori Rajonale të Mjedisit (DRM), të cilat nëpërmjet ndryshimeve ligjore të muajve të fundit, kalon në varesi të AKM. DRM-t kryejnë funksionet dhe kompetencat Brenda territorit të një Qarku të caktuar duke përfshirë të gjitha rrethet dhe komunat e bashkive të këtij qarku.

Në nivel vendor, bashkive dhe komunat janë përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, megjithatë nuk kanë njësi të specializuara mjedisore përveç bashkive të mëdha në vend si ajo e Tiranës, Durrësit, Elbasanit, Fierit, Shkodrës, etj. Në bazë të ligjit mbi organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore Nr. 8652, datë 31.7.2000, autoritetet lokale më të mëdha janë përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e rezervave ujore, mbetjeve urbane, infrastrukturën e transportit dhe zonat e gjelbra, në fillim të vitit 2001.

Bashkive dhe komunat janë gjithashtu përgjegjëse për menaxhimin e zonave pyjore të cilat kanë kaluar vitet e fundit me Vendim të Këshillit të Ministrave në administrimin e tyre.

## 2.5. Legjislacioni European per mbrojtjen e mjedisit

Proçesi i VNM-se do te marre ne konsiderate gjithashtu standartet Europiane te cilesise, sipas temes perkatese, qe permbahen ne Direktivat Europiane qe vijojne:

- Direktiva 2008/50/EC e Parlamentit European dhe Keshillit e 21 Maj 2008 mbi cilesine e ajrit ne ambient dhe ajer me te paster per Europen;
- Direktiva 2004/107/EC e Parlamentit European dhe e Keshillit e 15 Dhjetor 2004 persa i takon arsenikut, kadmiumit, zhives, nikelit dhe hidrokarbureve aromatike policiklike ne ajrin e ambientit;
- Direktiva e Keshillit 1999/30/EC e 22 Prillit 1999 persa i takon vlerave limit perdioksidin e squfurit, dioksidin e azotit oksidin e azotit, thermijave plumbit ne ajrin e ambientit;
- Direktiva 2002/60/EC e Parlamentit European dhe Keshillit e 25 Qershor 2002
- persa i takon vleresimit dhe menaxhimit te zhurmes mjedisore;
- Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit European dhe Keshillit qe percakton nje kuader per veprimet e Komunitetit ne fushen e politikës se ujit;
- Direktive te Parlamentit European dhe te Keshillit per standartet e cilesise se mjedisit ne fushen e politikës se ujit dhe ndryshimi i Direktives 2000/60/EC [COM(2006) 398];
- Direktiva 2006/12/EC e Parlamentit European dhe e Keshillit 5 prill 2006 mbi
- mbetjet dhe Propozimi per nje direktive te Parlamentit European dhe te Keshillit 21 Dhjetor mbi mbetjet [COM(2005) 667].

## Konventat dhe protokollet nderkombetare

### Protokolli i Montrealit

Pas zbulimit të vrimës së ozonit mbi Antarktidë, në vitin 1985, një numër i madhe vendesh u ndërgjegjësua për domosdoshmërinë e marrjes së masave të forta, për reduktimin e prodhimit si edhe të konsumit të një numri CFCs (11, 12, 113, 114, dhe 115) si edhe haloneve (1211, 1301 dhe 2402). Protokolli u hartua në 16 shtator 1987, nga Organizata e Aviacionit Civil në Montreal, dhe hyri në fuqi në 1 janar 1989, pasi u ratifikua nga 29 shtete si edhe BE. Më pas protokollin ka vazhduar të ratifikohet edhe nga shtete të tjerë. Protokolli përcakton dhe detyron si ai do të ndiqet në etapa të ndryshme, mbështetur në vlerësimet teknologjike dhe shkencore periodike.

Protokolli është amenduar herë pas here, me qëllim futjen e metodave të reja të matjes dhe kontrollit si edhe për të shtuar substanca të tjera në listën e substancave të ndaluara në mjedis.

## Samiti i tokes

Konferenca e Kombeve të Bashkuara, e mbajtur në Rio De Zhaneiro në korrik 1992, përcaktoi detyrimet lidhur me qëndrueshmërinë e zhvillimit të komunitetit global, për shekullin e 21-të. Paralelisht u diskutuan dy konventa. Në Kanada, dhjetor 1992 u nënshkrua dhe ratifikua një konventë lidhur me biodiversitetin. Kanadaja po ashtu ratifikoi kornizën ligjore të konventës së Rios. Këto konventa çuan në hartimin dhe ratifikimin e protokollit të Kiotos, 1997. Bazuar në këtë samit janë përcaktuar dy parime bazë:

- Deklarata e zhvillimit dhe mjedisit;
- Ruajtja e pyjeve.


Deklarata e Rios përcakton të drejtat dhe përgjegjësitë e qeverive për mirëqenien e popullatës, si edhe ruajtjen e burimeve dhe mjedisit edhe për brezat që do të vijnë. Ruajtja e pyjeve përcakton detyrimet lidhur me menaxhimin, ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tyre, duke mbajtur parasysh edhe nevojat e brezave të ardhshëm.

## Protokolli i Kiotos

Protokolli i Kiotos përfaqëson kornizën ligjore të Kombeve të Bashkuara mbi ndryshimet klimatike, në luftën kundër ngrohjes globale. Qëllimi i këtij traktati ndërshtetëror është “Stabilizimi i Nivelit të Çlirimit dhe Përqëndrimit të Gazeve me Efekt Serë”, me qëllim parandalimin e ndërhyrjeve të rrezikshme antropogjenike në sistemin klimatik global.



Ngjyrë e gjelbër, vendet që e kanë ratifikuar,



Ngjyrë e verdhë, vendet që janë angazhuar të eliminojnë tërësisht Emisionet



Ngjyrë e kuqe, vendet që nuk e kanë ratifikuar.

Ky traktat siguron reduktimin me 8% të emisioneve për BE. Protokolli i miratuar në 11 dhjetor 1997 dhe hyri në fuqi në 16 shkurt 2005. Në korrik 2010 ishte ratifikuar nga 191 shtete. Aneksi i tij specifikon se 37 vende do të reduktojnë me 5.2% çlirimin e emisioneve të gazeve serë, krahasuar me vitin 1991. Protokolli lejon aplikimin e “mekanizmave fleksibël”, si tregtimi i emisioneve, mekanizmat e zhvillimit të pastër (Clean Development Mechanism-CDM).

Çdo shtet pjesëtar i aneksit i duhet të hartojë dhe paraqesë një raport vjetor lidhur me çlirimet antropogjenike të gazeve me efekt serë, Raporti paraqitet nga një person, i quajtur “Autoriteti Kombëtar i Emëruar”, i cili ja adreson bordit ekzekutiv.

### **Marreveshja e Kopenhagenit**

Konsiderohet si vazhdim i protokollit të Kiotos. Kjo marrëveshje përcakton “Ndryshimet Klimatike” si një ndër sfidat më të mëdha të kohës dhe thekson se “Vetëm vendimet e guximshme dhe të forta politike do të mundësojnë minimizimin e tyre, përmes një aksioni të përbashkët, por diferencimeve në shkallën e marrjes së përgjegjësisë, mbështetur në aftësitë konkrete të çdo shteti”;

Parandalimi i ndërhyrjeve me natyrë antropogjenike në sistemet klimatike kërkon trajtimin dhe analizën shkencore të ndikimeve globale që mund të sjellë rritja e temperaturës mesatare me vetëm 2°C”, në kontekstin e qëndrueshmërisë së zhvillimit dhe minimizimit të ndryshimeve klimatike;

- Pranon “Ndikimin si edhe potencialin e madh të masave paraprake të shteteve të cilët do të preken më shumë nga ndryshimet klimatike” dhe thekson domosdoshmërinë “e hartimit dhe miratimit të një programi të përbashkët ndërkombëtar veprimi”;
- Pranon “Pakësimi i menjëhershëm i sasisë së emisioneve të çliruara, në nivel global duhet bërë në përputhje me rekomandimet e komunitetit shkencor dhe bie dakord se ky nivel duhet të bjerë në nivel shtetesh dhe ndërkombëtar sa më shpejt që të jetë e mundur, pasi kjo është një domosdoshmëri për arritjen e qëndrueshmërisë së zhvillimit”;
- Përcakton se “Nevojitet një bashkëpunim i ngushtë, në nivel ndërkombëtar me qëllim hartimin dhe adaptimin e masave urgjente për zvogëlimin e riskut si edhe rritjen e aftësive rehabilituese të vendeve në zhvillim, veçanërisht atyre që janë më shumë të kërcënuara, si vendet e pazhvilluar, shtetet ishuj në zhvillim si edhe kontesti Afrikan. Po ashtu, nevojitet parashikimi i burimeve të qëndrueshme financiare, teknologjike dhe atyre ndërtuese me qëllim mbështetjen e plotë, gjatë zbatimit të planeve të veprimit, nga këto vende”;

Lidhur me masat me karakter lehtësues bie dakord se vendet e zhvilluara (vendet e Aneksit I) duhet të arrijnë objektivat e parashikuar, lidhur me nivelin e emisioneve të gazeve me efekt serë brenda vitit 2020, të cila hyjnë në fuqi në 31 Janar 2010, madje objektivat e parashikuar nga protokollin e Kiotos duhet të bëhen akoma më të fortë”.

Reduktimi emisioneve dhe transaksionet financiare të vendeve të zhvilluara do të maten, verifikohen dhe raportohen në përputhje me udhërrëfyesin e hartuar për këtë qëllim;

- Vendet në zhvillim (shtet që nuk janë pjesë e Aneksit I) duhet të zbatojnë masa me karakter lehtësues, me qëllim reduktimin e emisioneve të gazeve me efekt serë, në përputhje me nivelet që hyjnë në fuqi në 31 Janar 2010. Vendet e pazhvilluara dhe ato në zhvillim duhet të ndërmarrin veprimet e tyre me karakter lehtësues, me ndihmën e institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare;
- Vendet në zhvillim duhet të raportojnë çdo dy vjet, për veprimet e kryera, pranë sekretariatit të Kombeve të Bashkuara, në përputhje me objektivat e tyre;
- Pranon rolin e madh të shpyllëzimit dhe degradimit të pyjeve në nivelin e emisioneve të gazeve me efekt serë dhe nevojën e mbajtjes në kontroll të tyre, si edhe domosdoshmërinë e përcaktimit të një mekanizmi që mundëson transferimin e burimeve financiare nga vendet e zhvilluara drejt atyre në zhvillim apo të pazhvilluara, me qëllim arritjen e objektivave të paracaktuara;

Kërkimi i mundësive të reja me qëllim optimizmin e kostos si edhe promovimin e planeve më të mirë të veprimit. Vendet në zhvillim, veçanërisht ato me nivel të ulët të çlirimit të emisioneve të gazeve me efekt serë, duhet të përfitojnë incentiva me qëllim që të vazhdojnë zhvillimin e tyre, në të njëjtën rrugë. Ku financime të reja, shtesë, do të jepen vendeve në zhvillim me qëllim mbështetjen e aktiviteteve të tyre përmirësuese.

Ndërsa vendet e zhvilluara do të krijojnë një fond prej 30 miliardë € nga burime të reja financiare ku do të përcaktojnë objektivin e krijimit të një fondi prej 100 miliardë €/vit, duke filluar nga viti 2020, për të ndihmuar vendet në zhvillim për reduktimin e Lirimit të emisioneve të karbonit. Ku fond të krijohet prej shumë shteteve dhe do të menaxhohet prej një strukture ndërqeveritare.

Përcaktimi dhe krijimi i “Fondit të gjelbër të klimës”, do jetë si një mekanizëm financiar operativ, për mbështetjen e projekteve, programeve dhe aktiviteteve të tjera të vendeve në zhvillim me qëllim marrjen e masave lehtësuese. Për këtë qëllim do të krijohet një panel i nivelit të lartë. Përcaktimi i krijimit të një mekanizmi teknologjik “për përshpejtimin e zhvillimit teknologjik dhe transferimit të saj, nga njëri vend në tjetrin”.

Afat maksimal të implementimit të marrëveshjes vitin 2015. Këtu përfshihet edhe rishikim dhe rivlerësimi i objektivave afatgjatë, si ulja e temperaturës me 1.5°C.

## **Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi ndryshimet klimatike 2010**

Kjo konferencë u mbajt në Kankùn, Meksikë nga 29 nëntor deri në 10 dhjetor 2010. U quajt si sesioni i 16-të i Konferencës së Palëve pjesëmarrëse të “Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara, mbi Ndryshimet Klimatike” dhe sesioni i 6-të i konferencës që krijoi “Protokollin e Kiotos”. Në lidhje me të, u krijuan dy trupa të përhershme të Kombeve të Bashkuara:

- Trupa mbështetëse për këshillim teknologjik e shkencor;
- Trupa mbështetëse për implementimin e marrëveshjes së aprovuar.

Konferenca mbi Ndryshimet Klimatike e Organizatës së Kombeve të Bashkuara e vitit 2009 e zgjeroi mandatin e këtyre trupave si edhe ngriti dy trupa të përkohshme:

- Grupin Ad Hoc, të punës për shtetet e Aneksit I të Protokollit të Kiotos;
- Grupin Ad Hoc për bashkëpunimin afatgjatë.

Rezultati i konferencës ishte miratimi i një marrëveshjeje, edhe pse jo një traktat ligjor, e cila kufizon efektin e ngrohjes globale me më pak se 2°C, përmes kërkesës që vendet e pasura të reduktojnë nivelin e çlirimit të emisioneve të gazeve me efekt serë, në përputhje me kriteret e Marrëveshjes së Kopenhagenit. Në marrëveshje u përfshi edhe krijimi i “Fondit të Gjelbër” prej 100 miliardë €/vit, duke filluar nga viti 2020, për mbështetjen e vendeve të varfra apo atyre në zhvillim për reduktimin e emisioneve edhe prej tyre. Nuk u arrit ndonjë marrëveshje për zgjerimin e Protokollit të Kiotos, apo se si do të shpenzohej ky fond. Po ashtu, nuk u arrit ndonjë marrëveshje për përcaktimin e detyrimeve ligjore për reduktimin e emisioneve nga vendet e pasura.

### **2.6. Metodologjia e Vleresimit**

Per hartimin e raportit të VNM, porositesi vuri në dispozicion të hartuesve të raportit materialin teknik të disponueshëm, juridik e stafin e subjektit dhe perfaqesuesit në ambjentin e fabrikes. Me bashkëpunimin e subjektit kerkues “BAMAS-BROLI” Sh.p.k u kryen vizita në terren nga grupi i punës.

MMPAU është autoriteti kompetent ligjor për të kerkuar, analizuar dhe aprovuar dokumentacionin e VNM, ku projekti në vleresim do të nënshtrohet procedurave të raportit të përmbledhur të VNM-se, si shpjegohet në mënyrë të detajuar si më poshtë:

VNM-i Permbledhur duhet te permbaje informacionin e me poshtem (neni 8):

- a) Qellimi i projektit;
- b) Pershkrim i detajuar i objektivave;
- c) Te dhena mbi mjedisin ekzistues te zones dhe zonave te aferta me zonen ku do te zbatohet projekti;
- ç) Pershkrim i hollesishem i te gjithë instalimeve qe jane pjese e projektit ose qe do te perdoren gjate zbatimit te tij;
- dh) Pershkrim i veprave inxhinierike qe jane ndertuar ose zgjeruar dhe i punimeve te nevojshme per zbatimin e projektit;
- e) Ndikimet e mundshme mbi mjedis dhe masat e propozuara per parandalimin ose zbutjen e tyre;
- e) Programi i monitorimit te ndikimit ne mjedis te projektit;
- f) Perputhjen e projektit me planin e rregullimit te territorit dhe me planin e zhvillimit ekonomik te zones ku do te zbatohet projekti;
- g) Permbledhje e konsultimeve me organet e qeverisjes vendore, organizatat jo-fitmprures publike dhe mjedisore dhe te opinioneneve te tyre;
- gj) Masat rehabilituese ne rastet e ndotjes dhe demtimit te mjedisit si dhe kostove te tyre;
- h) Nje kopje te licences te personit juridik ose organizates qe ka pergatitur raportin VNM.

Kjo duhet te mbeshtetet nga informacione ne lidhje me karakteristikat e projektit, vendndodhjen e projektit (te dhena per mjedisin, banoret dhe kulturen) dhe impaktin potencial te projektit, informacion i cili do te perdoret nga MM dhe do te percaktoje nevojen per nje VNM te Permbledhur. Ne rastin e zones ne vleresim ky projekt do te nenshtrohet procedurave te raportit te permbledhur te VNM-se.



**BAMAS-BROLI**  
**PRODHIM I LLAÇRAVETË THATA (KOLLË, FINO, LLAÇ I THATË, ETJ)**

Tabela: 1: Kriteret e klasifikimit per procedurat shqiptare te VNM-se

<b>Kategoria sipas Legjislacionit Shqiptar</b>	<b>Procedura qe Duhet Ndjekur (Duke plotesuar Standartet Shqiptare)</b>			
<p>Aneksi i Ligjit 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”                      (Lista e veprimtarive te cilat duhet te paisen me Leje Mjedisore te tipit A, B ose C)                      VKM Nr. 805, date 04.12.2003, “Për miratimin e listës së veprimtarive që ndikojnë në mjedis, për të cilat kërkohet leje mjedisore”</p>	<p>Sipas kerkesave te ligjit Nr 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”, Shtojca 1 per Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C , Pika 3.9, ky projekt klasifikohet tek lejet e mjedisit te Tipit C, por duke u konsultuar me AKM, ky projekt eshte vleresuar te paiset me Leje Mjedisore qe sipas raportit te permbledhur mund te konvertohet leje e tipit B te nenkategorise III.1.B sipas klasifikimit te VKM Nr. 538, date 26.05.2009.</p>			
<p>Udhezimit Nr. 3, date 02. 12. 2013 “Per dokumentacionin e domosdoshem per te kerkuar leje mjedisore te tipit A, B dhe C per aktivite te reja dhe ekzistuese” dhe sipas procedures se VKM Nr. 247, date 30.04.2014 Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore</p>	<p>Pergatitja e procedures se raportit te permbledhur te VNM-se, sepse ndodhet ne shtojcen II te ligjit per VNM.</p> <p>Organizimi i nje konsultimi me publikun, sipas kerkesave te Udhezimit Nr. 3, date 02. 12. 2013 “Per dokumentacionin e domosdoshem per te kerkuar leje mjedisore te tipit A, B dhe C per aktivite te reja dhe ekzistuese”</p>			
<p>Klasifikimi sipas Ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e Mjedisit”</p>				
<p>3.9</p>	<p>Prerja, gdhendja dhe lustrimi i gurit</p>	<p>-----</p>	<p>-----</p>	<p>Të gjitha instalimet</p>
<p>3.10</p>	<p>Prodhimi i produkteve abrazive dhe produkteve të tjera minerale jometalike</p>	<p>-----</p>	<p>-----</p>	<p>Të gjitha instalimet</p>

### 3 PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

#### 3.1. Qëllimi i aktivitetit

Qëllimi i funksionimit të këtij aktiviteti është prodhimi i llaçrave të thata për përdorim të gjërë në fushën e ndërtimit. Me llaçra të thata do të kuptojmë Kolle, Fino, Llaç i thatë, grafiato etj). Objekti ndodhet në Rrugë Martin Camaj, unaza Shkozë-Plepa DURRES.

#### 3.2. Te dhëna teknike të aktivitetit

Subjekti "BAMAS-BROLI" Sh.p.k i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, mbajtes i numrit unik të identifikimit të subjektit (NIPT) KO1328505B, Rrugë Martin Camaj, unaza Shkozë-Plepa DURRES me administrator Z. Julian Broli dhe Z. Zija Broli ushtron aktivitetin e prodhimit të llaçrave të thata si kolle, fino, llaç i thatë, etj.

Subjekti, për zhvillimin e aktivitetit të tij është paisur me të gjitha miratimet përkatëse të lejeve të nevojshme për objektin dhe është duke aplikuar për paisjen me lejen mjedisore të funksionimit të aktivitetit. Ky aktivitet ndodhet në zonë industriale dhe në përputhje me planet e zhvillimit dhe studimet urbanistike të zonës.

Objekti i kantonit në dispozicion të këtij aktiviteti ka këto të dhëna urbanistike:

Sipërfaqe e objektit (njolla e ndërtimit)	= 500m <sup>2</sup>
Koeficienti i shfrytëzimit të territorit	=37
% Koeficienti i sipërfaqes së gjelbert	=20 %

Kapaciteti prodhues i produktit përfundimtar do të jetë rreth 4 ton/ditë. Kapaciteti magazinues rreth 80 ton, ku destinacioni është kryesisht për eksport.


Uji sigurohet me pus dhe në ambientin e fabrikës është ndërtuar edhe sistemi zjarrfikës në funksion të objektit dhe zyrave. Ky investim është kryer për të rritur sigurinë në objekt dhe për të garantuar investimin e impiantit modern dhe plotësisht automatik.



**BAMAS-BROLI**  
PRODHIM I LLAÇRAVETË THATA (KOLLË, FINO, LLAÇ I THATË, ETJ)

**3.3. Vendodhja e aktivitetit**

Aktiviteti ne vleresim ndodhet ne Rruga Martin Camaj, unaza Shkozet-Plepa DURRES



N	E
41 ° 18 ' 57.69 "	19 ° 29 ' 56.45 "

### **3.4. Lidhja e objektit me infrastrukturen Inxhinierike**

Objekti, ne te cilin eshte instaluar impianti dhe funksionon aktiviteti prodhues i subjektit "BAMAS-BROLI" Sh.p.k eshte i ndertuar para disa vitesh dhe eshte i lidhur me infrastrukturen inxhinierike te zones. Infrastruktura rrugore eshte ajo e Infrastruktura e energjise elektrike eshte e lidhur nepermjet nje kontrate me subjektet administruese si CEZ Sh.a. Sistemi i kanalizimeve eshte ekzistues i zones industriale pasi ne kete zone ka edhe disa subjekte te tjera me aktivitet tregtar, magazinues dhe procese perpunimi te industrise se lehte. Persa i perkete furnizimit me uje, eshte mundesuar me pus, pasi furnizimi nga ujesjellesi nuk mundeson furnizim me uje per aktivitetet industriale dhe ne sasine e nevojshme. Sistemi i mbrojtjes nga zjarri eshte i ndertuar posacerisht per kete qellim dhe funksionon nepermjet hidranteve te cilet jane te lidhur me sistemin e pompimit. Per funksionimin e sistemit te pompimit eshte ndertuar edhe nje depo uji nentokesore e cila qendron e mbushur per raste emergjence.

### **3.5. Përshkrimi i procesit teknologjik te fabrikes.**

Projekti perbehet nga dy linja bluarje granilit te pa varura nga njera tjetra dhe nga dy linja te prodhimit te materialit te thate. I gjithë procesi i bluarjes dhe ai prodhimit fillohet dhe komandohet nepermjet pultit te komandimit i vedosur ne ambientet e brendeshme te fabrikes.

Materiali i gurit gelqeror i granulacionit (granil 1-3) hidhet ne bunker nga 1 per secilen linje mbasi eshte verifikuar cilesia dhe pastertia e tij.

Nga bunkeri nepermjet transportueseve ai hidhet ne mullirin e bluarjes i cili rrotullohet me shpejtesi 1710 rrot/min (shpejtesi e ndryshueshme ne varesi te procesit )per copetimin e tij ne granulacion te ndryshme. Pas daljes nga mulliri i bluarjes nepermjet shnekeve(kermillor) dhe elevatorit ai futet ne pjesen e tharjes e cila eshte nje site vibruese ku futet ajer i ngrohte ose i ftohte ne varesi te perqindjes se lageshtires se materialit. Ketu behet dhe ndarja e materialit nga pluhuri i cili nuk i kalon granualin 0.9 mikron nepermjet filtrit te bluarjes i vendosur me tubin e thithjes ne pjesen e siperme te tharses perkatese, dhe nepermjet shnekut dhe elevatorit pluhuri dergohet ne sillosin perkates per pluhurin. Pjesa e mbetur e materialit ne granulacion te ndryshem pa pranine e pluhurit dergohet nepermje elevatorit dhe shnekeve ne sitat e ndarjes se garanulacionit te ndryshem sipas kerkeses.

Secila linje perbehet nga dy grupe sitash ku perfshihet sipas rendit sita 3 mm,2 mm,1.2 mm dhe sita 0.6 mm te cilat rrotullohen, dhe materiali shperndahet ne silloset perkates siapas granulacionit qe kane.

Materiali i cili per arsye te granulacionit me te madhe se 3 mm kthehet perseri ne bunker nepermjet transportuesit per riciklimin e tij.

Me futjen e materialit neper silloset perkates siapas granulacionit mbyllet dhe procesi i bluarjes se granilit.

Pjesa e prodhimit te llacit te thate.

Pas dhenies se receptures perkatese nga pulti i komandimit materialit merret nga silloset ku eshte i magazinuar dhe futet ne peshoret elektronike per peshim. Ne baze te sasise se kerkuar nga receptura perkatese materialit i peshuar neper peshoret futet ne pjesen e miksimit (perzierjes).

## BAMAS-BROLI PRODHIM I LLAÇRAVETË THATA (KOLLË, FINO, LLAÇ I THATË, ETJ)

Material i miksuar pasi ka mbushur kohen perkatese te miksimit leshohet ne depoziten poshte tij dhe ne menyre automatike fillon pergatitja per sasine tjeter te rradhes

